



Parimi i respektimit dhe Mbrojtjes së Dinjitetit të Njeriut

MSc. Julian Fakaj

Abstract

The protection of human rights and freedoms is a key pillar in the normal functioning of democratic states because the political, economic and legal development of a democratic state depends directly on the respect of the rights and freedoms. This has been demonstrated by the Euro-Western (Scandinavian) states where respect for human rights and freedoms has reached the zenith and are the most powerful economic, social and democratic states. According to Article 15 of the Constitution of the Republic of Albania "Fundamental rights and freedoms are inseparable, inalienable and inviolable and remain the foundation of the entire juridical order"

The protection of human rights and freedoms has come as a result of the influence of many different factors, but the most important is causing the violence or unfair wars that have occurred throughout the historical periods of humanity. In general, the category of elders, women and children has been endangered, since in the natural aspect, these are more subordinated to the other layer that is likely to cause wars of catastrophic human dimensions.

Key words: protection, freedom, respect, normal functioning, democratic state.

Abstrakt

Mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut janë shtyllë kryesore në funksionimin normal të shteteve demokratike sepse nga respektimi i të drejtave dhe lirive varet drejtpërdrejt zhvillimi politik, ekonomik dhe juridik i një shteti demokratik. Këtë e kanë dëshmuar shtetet euro – perëndimore (skandinave) ku respektimi i lirive dhe të drejtave të njeriut ka arritur në zenit dhe janë shtetet më të fuqishme ekonomike, sociale dhe demokratike. Sipas Nenit 15 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë "Te drejtat dhe liritë themelore janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të gjithë rendit juridik"

Mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut ka ardhur si rezultat i ndikimit të shumë faktorëve të ndryshëm por më i rëndësishëm është shkaktimi i dhunës apo luftërave të padrejta që kanë ndodhur përgjatë gjithë periudhave

historike të njerëzimit. Në përgjithësi ka qenë e rrezikuar kategoria e pleqve, grave dhe fëmijëve pasi që në aspektin natyror këta janë më të subordinuar ndaj shtresës tjetër të cilët kanë mundësi të shkaktojnë luftëra të përmasave katastrofike njerëzore.

Fjalë kyçe: mbrojtje, liri, respektim, funksionim normal, shtet demokratik.

* * *

Mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut janë shtyllë kryesore në funksionimin normal të shteteve demokratike sepse nga respektimi i të drejtave dhe lirive varet drejtpërdrejt zhvillimi politik, ekonomik dhe juridik i një shteti demokratik. Këtë e kanë dëshmuar shtetet euro – perëndimore (skandinave) ku respektimi i lirive dhe të drejtave të njeriut ka arritur në zenit dhe janë shtetet më të fuqishme ekonomike, sociale dhe demokratike. Sipas Nenit 15 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë "Te drejtat dhe liritë themelore janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të gjithë rendit juridik"¹

Mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut ka ardhur si rezultat i ndikimit të shumë faktorëve të ndryshëm por më i rëndësishëm është shkaktimi i dhunës apo luftërave të padrejta që kanë ndodhur përgjatë gjithë periudhave historike të njerëzimit. Në përgjithësi ka qenë e rrezikuar kategoria e pleqve, grave dhe fëmijëve pasi që në aspektin natyror këta janë më të subordinuar ndaj shtresës tjetër të cilët kanë mundësi të shkaktojnë luftëra të përmasave katastrofike njerëzore.

Te drejtat e njeriut kanë të bëjnë me të drejtën e jetës, e cila mbrohet me ligj dhe lirinë e barazinë ndërmjet njerëzve. Këtë e gjejmë në nenin e parë të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, "të gjithë njerëzit lindin të lirë e të barabartë në dinjitet e në të drejta"². Ata kanë arsye dhe ndërgjegje dhe duhet të sillen ndaj njeri-tjetrit me frymë vëllazërimi.

Të drejtat politike dhe ekonomike kanë të bëjnë me të drejtën e votës, të cilën e gëzon çdo person që ka mbushur moshën 18 vjeçare, të drejtën për tu organizuar për çfarëdo qëllimi të ligjshëm, të drejtën e çdo personi për të drejtuar ankesa ose vërejtje institucioneve shtetërore, të cilat janë të detyruara të përgjigjen në

¹ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 1998, fq. 4

² Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Neni 1



afatet dhe kushtet e përcaktuara me ligj, e drejta për të hapur një biznes etj.

Të drejtat sociale dhe kulturore kanë të bëjnë me të drejtën për punësim; të drejtën për shkollim; të drejtën për sigurime shoqërore etj. këto të drejta janë të lidhura ngusht me njëra-tjetrën.

Të drejtat personale kanë të bëjnë me të drejtën e jetës , e cila mbrohet me ligj dhe lirinë e barazinë ndërmjet njerëzve. këtë e gjejmë në nenin e parë të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut; "Të gjithë njerëzit lindin të lirë e të barabartë në dinjitet e në të drejta. Ata kanë arsye dhe ndërgjegje dhe duhet të sillen ndaj njeri-tjetrit me frymë vëllazërimi"³.

Të drejtat politike dhe ekonomike kanë të bëjnë me të drejtën e votës, të cilën e gëzon çdo person që ka mbushur moshën 18 vjecare; të drejtën për tu organizuar për çfarëdo qëllimi të ligjshëm; të drejtën e cdo personi për të drejtuar ankesa ose vërejtje institucioneve shtetërore, të cilat janë të detyruara të përgjigjen në afatet dhe kushtet e përcaktuara me ligj; e drejta për të hapur një biznes etj. " Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës me punë të ligjshme, që e ka zgjedhur vetë. Ai është i lirë të zgjedh profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të tij profesional"⁴ sipas Nenit 49 të K.Republikës së Shqipërisë.

Të drejtat sociale dhe kulturore kanë të bëjnë me të drejtën për punësim; të drejtën për shkollim; të drejtën për sigurime shoqërore etj. këto të drejta janë të lidhura ngusht me njëra-tjetrën. Të drejtat e njeriut janë një pjesë e rëndësishme e teorive të së drejtës dhe një koncept i rëndësishëm filozofiko-politik.^[1] Mes të drejtave themelore të genies njerëzore janë e drejta e lirisë individuale, e drejta për jetën, e drejta e vetvendosjes, e drejta e fesë etj.

Të Drejtat e Njeriut përshkruajnë një koncept sipas të cilit të gjithë njerëzve iu takojnë që nga lindja të drejtat universale njerëzore.

Termi "të drejtat e njeriut" është një koncept që ka ndryshuar (në kuptim të evolimit) gjatë gjithë historisë. Nëse shikohet në mënyrë kronologjike, njerëzimi nuk ka "luftuar" prej fillimit për të gjitha të drejtat që sot ekzistojnë dhe i gëzojmë. Pra, lufta për të drejtat e njeriut fillon me përpjekjet për t'u njohur të drejtat e njeriut fillon me përpjekjet për t'u njohur të drejtat më themelore (elementare) të tilla si : e drejta për jetën dhe e drejta për të qenë i lirë.

Nëse do të shohim zhvillimin historik për sa i përket të drejtave të njeriut, ndoshta do të mund të bënim një ndarje të zhvillimi të tyre në tri faza, me atë rast kemi :

2.1. Fazën e të drejtës natyrore (rrënjët filozofike të të drejtave të njeriut) Në këtë fazë do të mbisundojë ideja e barazisë së pretenduar të gjithë njerëzve (e drejta natyrore), e cila vlen për të gjithë, është zhvilluar qysh në filozofinë antike greke, pra para më shumë se 2000 vjetësh. Në krishterimin e hershëm dhe në fetë e tjera, kjo traditë e të drejtave të njeriut është zhvilluar më tej: Të gjithë njerëzit janë krijuar të barabartë nga Zoti dhe të gjithë kanë detyrime të barabarta përpara tij. Apo nga feja tjetër (myslimane) do të theksonim "të gjithë njerëzit janë

të barabartë, sikurse dhëmbët nuk ka të drejta i bardhi mbi të ziun , apo arabi mbi jo-arabin..." Këto parime përbëjnë rrënjët e idesë së të drejtave të njeriut. Megjithatë, në atë kohë, ato nuk kishin të bënin shumë me realitetin politik. Ato pasqyronin më shumë mendime filozofike, të cilat edhe pse në fakt kishin ngritur kërkesa universale, zbatimin praktik në jetën politike e përjetuan hap pas hapi në fillim të Epokës së Re. Shumë jurist, politikane dhe filozof të shekujve XVI, XVII dhe XVIII (Hugo Grotius, Xhon Locke, Spinoza, Jean Jack Rousseau, Jefferson etj.), nën ndikimin e teorisë të së drejtës natyrore , fillojnë t'i trajtojnë të drejtat e njeriut si të drejta të përcaktuara me "ligj hyjnorë" ose me "ligj të Perëndisë". Sipas këtyre autorëve njerëzit si individ lindin me disa të drejta (të cilat "u'a jep" e drejta mbishtetërore , apo natyrore) dhe këto të drejta nuk mund të kufizohen me norma pozitive të krijuara nga shoqëria. Duke pasur parasysh mendimet e dhëna nga autorët e lart përmendur, zhvillimin e mëvonshëm të të drejtave të njeriut mund ta shtrojmë në fazën e ardhshme.

2.2. Faza e dytë: zbatimi politik në kuadrin e shteteve kombëtare: Në këtë fazë është karakteristike marrja e disa prej të arriturave në lëmin e të drejtave të njeriut (edhe të atyre nga e drejta natyrore) në aktet e shteteve kombëtare. Anglia ka luajtur rol vendimtar gjatë këtij zhvillimi. E ashtuquajtura "Magna Charta Libertatum ", e cila i kufizoi mbretit disa të drejta, "Petition of Rights ", siguroi paprekshmërinë e qytetarëve, ndërsa dosja" Habeas-Corpus" e vitit 1679 shënoi kalimin vendimtar në fazën e shpalljes së idesë së të drejtave të njeriut si të drejta të shprehura me ligj, në të drejtën konkrete të shtetit. Në të, qytetari u mbrojt nga arrestimi i paarsyeshëm: Detyrimi për t'u sjellë para gjykatësit brenda 20 ditëve i të arrestuarit. Shtetet e Bashkuara të Amerikës në kuadrin e luftës për pavarësi, duke u mbështetur në idenë e Xhon Lokut, u formuluan katalogun e parë në histori për të drejtat e njeriut, "Virginia Bill of Rights" i vitit 1776, i cili bashkë me " Deklaratën Amerikane të Pavarësisë" të po të të njëjtit vit, numërohen si dokumentet më të rëndësishme në historinë e të drejtave njeriut. Virginia Bill of Rights" ngriti të drejtat e shënuara më poshtë si të drejta të patjetërsueshme të njeriut, të cilat që nga ajo kohë përbëjnë thelbin e të drejtave të njeriut: E drejta për jetë, liri dhe pasuri, Liria e mbledhjes dhe liria e shtypit, E drejta e peticionit, E drejta për mbrojtje juridike dhe E drejta e votës⁵. Në Francë, zbatimi në formën kushtetuese i idesë së të drejtave të njeriut mori përmasa të përshpejtuara. Revolucioni Francez i vitit 1789 pati ndikim shumë të madh. Më 26 gusht 1789 u pranua "Deklarata për të Drejtat e Njeriut dhe atyre Qytetare". Në të bie në sy përpjekja e theksimit të rëndësisë universale të të drejtave të njeriut. Me rëndësi të veçantë, në fillim ishte përfshirja e të drejtave të njeriut si të drejta themelore në kushtetutat kombëtare, gjë që u arrit me sukses gjatë shek. XIX në thuajse të gjitha shtetet evropiane. Zbatimi i plotë politik dhe juridik i idesë filozofike të të drejtave të njeriut u arrit deri në mesin e shekullit XX.

2.3. Faza e tretë: Realizimi universal politik (Kombet e Bashkuara) Ishte lufta e dytë botërore ajo që do të

³ Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Neni 1

⁴ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 49, fq. 10

⁵ Virginia Bill of Rights".



shpejtonte procesin e globalizimit të çështjes së të drejtave të njeriut. Tendencat ishin që jo që kishte ndodhur në këtë luftë, nuk duhet të përsëritej më. Të gjithë njerëzit në botë duhet të gëzonin të drejta dhe liri themelore. Kjo ishte njëherazi edhe arsyeja kryesore e themelimit të Kombeve të Bashkuara. Kjo gjë u garantua me nënshkrimin e marrëveshjes ndërmjet shteteve, nëpërmjet të ashtuquajturës Karta e Kombeve të Bashkuara, e cila u aprovua më 26 qershor të vitit 1945. Me këtë kartë, të gjitha shtetet anëtare detyrohen për bashkëpunim të ndërsjellë, dhe po ashtu çdo shtet i veçantë është i detyruar të bashkëpunojë me OKB-në, me qëllim që të arrihen qëllimet e saj (neni 56). Ndër qëllimet e Organizatës së Kombeve të Bashkuara është edhe vënia në jetë e të drejtave të njeriut. Sipas këtij neni, çdo anëtar i Kombeve të Bashkuara është i

detyruar të respektojë të drejtat e njeriut. Anëtarë të organizatës, sot janë thuajse të gjitha vendet e botës. Për të përkufizuar saktë të drejtat e njeriut, është përpiluar edhe "Deklarata e Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut", e cila është aprovuar në dhjetor të vitit 1948. Më vonë do të miratohen edhe akte të tjera nga OKB, si : Pakti për të drejtat Civile dhe Politike (janar 1976) ,Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (mars 1976), etj. Nëse do të futnim në këtë fazë edhe organizatat regjionale për sa i përket të drejtave të njeriut do të përmendim Këshillin e Evropës dhe disa nga aktet më të rëndësishme të kësaj organizate si :Konventa evropiane e të drejtave të njeriut (me protokollet e saj) , Kartën Sociale Evropiane (me ndryshimet e bëra) etj.

Bibliografia

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 1998, fq. 4
- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Neni 1
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 1998, fq. 10
- "Virginia Bill of Rights".